



IУ ЗАВОД ЗА СОЦИЈАЛНИ ДЕЈНОСТИ – СКОПЈЕ

# Si mund të ketë fëmija i prindërve të shkurorëzuar një fëmijëri të lumtur dhe pa brenga

*Shkup, Gusht 2020*



Fëmija ka të drejtë të jetojë një fëmijëri të lumtur dhe pa brenga. Mirëqenia dhe lumturia e fëmijës suaj varet vetëm nga ju si prindër dhe nga vendimi juaj se si do të vazhdoni të funksiononi si prind në të ardhmen. Kur fëmija juaj do të kupton dhe pranon që ndarja nuk ka lidhje me dashurinë tuaj për të dhe se shkurorëzimi ka ndodhur sepse nëna dhe babai nuk mund të jetojë së bashku, fëmija fillon të përshtatet me rrethanat e reja. Në rrethana të këtilla, prindërit e përgjegjshëm dhe prindërit që e duan fëmijën e tyre, zgjedhin rrugën që garanton interesin më të mirë të fëmijës. Por, ka edhe situata që mund të dëmtojnë më tej fëmijën dhe të sjellin pasoja të përhershme.

**FËMIJA JUAJ NUK ËSHTË TRANSMETUES I  
POROSIVE TUAJA -**

**FËMIJA JUAJ NUK ËSHTË "KORRIER /  
POSTIER" I NËNËS APO BABAIT**

Fëmijës tuaj nuk i pëlqen ndjenja kur ai doemos duhet të jetë transmetues i mesazheve mes jush - prindërve të tij, dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për porosi fajësie ndaj prindit tjetër. Fëmija juaj dëshiron që nëna dhe babai të flasin me edukatë, pa ndjenjën e presionit apo frikës se ai do të thotë diçka që do ta përkeqësojë tërë situatën. Ju si prindër duhet patjetër të merrni përgjegjësi, të flisni drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, veçanërisht në temat me interes për fëmijën tuaj. Mos dërgoni mesazhe ish-partnerit tuaj përmes "korrierit", d.m.th. fëmijës tuaj, thjesht sepse për ju është e vështirë, e pakëndshme ose e çuditshme për të biseduar me njëri-tjetrin për çështje ose probleme të pazgjidhura në martesën tuaj. Sjellja e tillë - vendosja e fëmijës në rolin e "korrierit" është një shembull i keq për të. Me këtë fëmija mëson se problemet zgjidhen duke i shmangur komunikimit të drejtpërdrejtë, bisedës së qytetëruar dhe se për të përcjellë ndjenja dhe emocione mundë të shfrytëzohet/keqpërdoret dikush tjetër.

Ju si ish-partnerë, por edhe më tej prindër të përbashkët, duhet patjetër të bisedoni në mënyrë të drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, veçanërisht për gjëra që ju lidhin si prind, siç është kujdesi, edukimi, arsimimi dhe shëndeti i fëmijës.



**MOS FLISNI KEQ PËR PRINDIN TJETËR -**

**AS NËNA DHE AS BABAI NUK JANË "DELE E ZEZË"**



Fëmija juaj nuk dëshiron të dëgjojë kritika ndaj prindërve të tyre, veçanërisht kur ato thuhet nga goja e prindërve të tyre të dashur. Kur fëmija juaj dëgjon gjëra negative për prindin tjetër, në të vërtetë dëgjon gjëra të këqija rreth gjysmës së vetvetës. E gjithë kjo ndikon në besimin dhe vetëvlerësimin e fëmijës tuaj, bëhet i pasigurt, humbë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin. Nëse nuk mund të gjeni të paktën disa fjalë të mira për ish-partnerin tuaj, më mirë është që të mos thoni asgjë. Shprehjet e mëposhtme dhe të ngjashme nuk janë të këndshme për fëmijën tuaj, ai nuk dëshiron ti dëgjojë këto: "Njësoj/je si nëna jote/babai yt, kokëfortë si dhe nervoz"; "Nëse babait/nënës tuaj i intereson se si jemi, nuk do të sillen kështu..." Nëse babai/nëna do t'ju donte, në kohë do të dërgonte para"; Ashtu si babai/nëna juaj, një ditë do të shkosh dhe do të largohesh nga unë."

Shprehjet e ngjashme dhe të tilla te fëmija juaj shkaktojnë frikë, pasiguri, shqetësim, siklet, ankth dhe nervozë.



**MARRJA NË PYETJE E FËMIJËS PËR PRINDIN TJETËR -**  
**FËMIJA JUAJ NUK ËSHTË "INFORMATOR NË DETYRË".**

Mos e përdorni fëmijën tuaj si instrument për të marrë informacione në lidhje me atë që po ndodh në shtëpinë e ish-partnerit tuaj. Kur fëmija juaj flet për ngjarjet dhe kohën e kaluar me prindin tjetër, duhet të jeni të vëmendshëm, të interesuar dhe dëgjues të sjellshëm, ndërsa komentet/pyetjet ironike, mbani për veten tuaj.

**PËRFSHIRJA E FËMIJËS NË KËRKESAT PËR**  
**ALIMENTACION –**

**FËMIJA JUAJ NUK ËSHTË MJET PËR PAGESË**  
**TË LLOGARIVE, USHQIMIT, VESHJES, ARSIMIMIT**  
**DHE...**

Mos e përfshini fëmijën tuaj në çështjet e alimentacionit/mbështetjes. Edhe pse pagimi i alimentacionit është një nga problemet më të zakonshme dhe më të mëdha, sidoqoftë çështjet lidhur me përkrahjen financiare dhe mbështetjen e fëmijës duhet patjetër t'i mbani larg fëmijës. Nëse grindeni para fëmijës me ish-partnerin i cili është përgjegjës për alimentacionin/mbështetjen, atëherë te fëmija do të rritet ndjesia e fajit se është përgjegjës për raportet jo të mira, grindjet, mosdurimit dhe të gjitha problemeve që kanë të bëjnë midis nënës dhe babait.

## MBAJTJA E ANËS-

**MOS E VENDOSNI FËMIJËN TUAJ NË LËKUNDJE  
TË PËRHERSHME  
„NËNA APO BABAI?! "BABAI APO NËNA?!"**

Fëmija juaj ju donë njësoj të dyve – edhe nënën edhe babanë. Mos kërkonin nga ai të zgjedhë anë për çështje të caktuara, kjo i shkakton më shumë stres fëmijës, i cili nuk mund ta tejkalon dhe ndikon negativisht në gjendjen dhe stabilitetin e përgjithshëm të fëmijës tuaj. Mbjajtja e anës dhe përkatësia e njërit nga prindërit bën që fëmija juaj të ndiejë faj, mosbesnikëri dhe ndërgjegje, të cilat ndikojnë në jetën e përgjithshme të fëmijës dhe ndikojnë negativisht në përqendrimin, mësimin, ndjenjat, sjelljen, komunikimin, shoqërimin dhe...

Shpesh pyesni: "Me kë doni të jetoni?" Me nënën apo babain? "Nëse thotë babain, atëherë fëmija ndjen mosrespektim të besnikërisë dhe ka tradhtuar nënën e tij; nëse thotë nënën atëherë ndihet i pabesë dhe e ka tradhtuar babanë. Në situata të tilla, fëmija zgjedh gjithmonë anën e prindit që po e pyet për momentin. Shumë e mençur, apo jo? Nëse ju si prind prisni që fëmija të marrë anën tuaj dhe prindin tjetër ta refuzojë, ju i mveshni ngarkesë të madhe fëmijës, në vend që ta kurseni dhe mbroini atë nga vendimet/përgjegjësitë që ju si prindër duhet reciprokisht ti merrni dhe negocioni.



## NEGLIZHIMI I KONTAKTEVE ME PRINDIN TJETËR -

**"PASI QË NËNA / BABAI TË KA LËNË, DONË TË THOTË NUK TË DO"**



Interesi më i mirë i çdo fëmije, pa marrë parasysh a jeton apo jo me të dy prindërit, është të arrijë dhe të kontaktojë me të dy prindërit.

Mundësoni që fëmija juaj të krijojë dhe mbajë kontakte me prindin që nuk jeton. Prindi përgjegjës dhe prindi që e do fëmijën e tij e kupton dëshirën dhe nevojën e fëmijës të mbajë kontakte me prindin tjetër me të cilin nuk jeton.

Fëmija që ka kontakte të rregullta me prindin tjetër nuk ndihet i refuzuar, i padëshiruar dhe përshtatet më mirë me mjedisin.

Kur fëmija nuk mbanë kontakte me prindin tjetër pas ndarjes, na duket se janë shmangur të gjitha problemet dhe tensionet e mundshme.

Edhe në raste kur fëmija nuk bën pyetje dhe nuk e kërkon prindin tjetër, nuk do të thotë që ai ka ndaluar së dashuruar dhe të harrojë prindin tjetër. Në fakt, kjo do të thotë që fëmija mëson të mos bëjë pyetje për të cilin prindi me të cilin jeton nuk dëshiron të përmendet ose të dëgjohet.

Nëse ju si prind inkurajoni dhe mbështesni kontaktet e fëmijës suaj me prindin tjetër, kjo do të thotë që ju e doni fëmijën tuaj dhe kështu mundësoni që fëmija të identifikohet me të dy prindërit gjatë zhvillimit të tij/saj. Nëse ju si prind i kuptoni nevojat e fëmijës tuaj dhe nëse reagoni në mënyrë të duhur, të dy, pavarësisht



se ku jeton fëmija, mund me sukses të përmbushni rolin si prindër. Nuk ka dyshim që ju si prind merrni pjesë në kujdesin e përgjithshëm të fëmijës (rritje, zhvillim, mësim dhe përkujdesje). Qëndrimi i fëmijës me prindin tjetër nuk paraqet vetëm lojë dhe shoqërim të fëmijës me prindin por gjithashtu përkushtim në mësim dhe ndihmë në kryerjen e të gjitha aktiviteteve shkollore të fëmijës.



**KOMUNIKIMI NDËRMJET PRINDËRVE -**

**"TANI DO TË TREGOJ SE KUSH ËSHTË  
KRYESORI DHE DO TË PAGUANI PËR  
GJITHÇKA".**

Mos harroni se pas shkurorëzimit edhe pse jeni të ndarë dhe nuk jetoni më me ish-partnerin tuaj dhe fëmijën tuaj, ju përsëri nuk pushoni së qeni prind. Ju si prindër keni nevojë dhe duhet të bashkëpunoni me njëri-tjetrin, për të mbështetur dhe ndihmuar njëri-tjetrin në prindërim, si dhe në realizimin e nevojave të jetës dhe zhvillimit të fëmijës tuaj. Kjo veçanërisht është e nevojshme kur zgjidhen momente kritike, situata dhe probleme që kanë të bëjnë me fëmijën, sepse askush nuk e njeh fëmijën tuaj më mirë se ju, si prindër.

Në situata kur nuk pajtoheni për disa çështje si prindër që lidhen me fëmijën tuaj, është e nevojshme dhe patjetër duhet të mbani komunikim të ndërsjellë kulturor dhe të denjë para fëmijës. Kur jeni në prani të fëmijës tuaj, gjithmonë me ish-partnerin tuaj përmbaheni nga momentet dhe situatat e pakëndshme, kontrolloni sjelljen dhe komunikimin tuaj, pavarësisht ndjenjave dhe qëndrimeve që keni për njëri-tjetrin. Mos harroni, ju jeni duke komunikuar dhe bashkëpunoni si prindër për hir të nevojave të fëmijës tuaj, jo për hir të zgjidhjes së çështjeve ose problemeve të pazgjidhura me ish-partnerin tuaj.



### MARRËVESHJE PËR KOHËN

**"NUK E DI, DO TË SHOHIM, DO TË MERREMI VESH. OSE TË SHTUNËN, OSE TË DIELËN, OSE..."**



Ju akoma jeni prind edhe për kohën kur/si do të krijoni kontakt me fëmijën tuaj, gjithmonë dakordoheni me prindin tjetër. Gjithmonë merreni parasysh obligimet formale dhe joformale të fëmijës/ nevojat e fëmijës (kopshti/shkolla; sporti/rekreacioni; pushimet/udhëtimet; shoqërimi/argëtimi, etj.), si dhe statusi i tij i përgjithshëm ose gjendja shëndetësore.

Ju nuk duhet ta përdorni gjendjen, përgjegjësitë dhe nevojat e fëmijës si arsye për të kufizuar dhe pamundësuar kontaktet e ish-partnerit tuaj me fëmijën tuaj. Mos harroni, fëmija juaj ka nevojë për të dy prindërit në mënyrë të barabartë, të dyve ju duan njësoj.

Koha e takimeve gjithmonë paraprakisht duhet të koordinohet, duke pasur parasysh gjithmonë interesin për fëmijën tuaj, ndërsa informojeni gjithherë fëmijën sa i përket caktimit të kohës dhe kohëzgjatjen. Si prindër duhet të keni qëndrim në zbatimin dhe realizimin e marrëveshjeve tuaja. Mosrespektimi i marrëveshjeve për sa i përket kohës së takimeve të mbërritjes ose kthimit të fëmijës, do të nënkuptojë jo vetëm mosrespektimin e kohës së fëmijës, por edhe mosrespektimin e vetë fëmijës, gjë që shkakton pasiguri, zhgënjim të fëmija juaj dhe lind një ndjenjë ngurrimi dhe refuzimi.

# MBANI MEND:

**"ME NDARJE MBARON MARTESA  
DHE BASHKJETESA,  
POR PRINDËRIMI JO!"**

## **MOS HARRONI:**

**"JU TËRË JETËN DO TË JENI DHE DO  
TË MBETENI PRINDËR TË FËMIJËS TUAJ!"**

*Kur jeni në dilemë, Ju shqetësojnë pyetjet për të cilat nuk keni ose nuk e dini përgjigjen, keni nevojë për informacione, si dhe këshilla/mbështetje në lidhje me prindërimin, gjithmonë mund të kontaktoni Qendrën për Punë Sociale e cila është përgjegjëse për vendbanimin tuaj*

Teksti është përgatitur nga ekspertë të IP Entit për Veprimtari Sociale - Shkup  
Psikolog. S.P. Mishevska, m-r. Pedagog. B. Simonovska,  
jurist i diplomuar S. Kiprovska



**Македонско здружение на млади правници**

Брошурата е поддржана од  
Македонското здружение на млади правници